

Racionalizimi i Agjencive të Pavarura Rregullatore në Kosovë: Cilat janë opsionet?

Maj 2021



GROUP FOR LEGAL
AND POLITICAL
STUDIES



GRUPI PËR STUDIME
JURIDIKE DHE
POLITIKE

Grupi për Studime Juridike dhe Politike

Grupi për Studime Juridike dhe Politike është institut i politikave publike, i pavarur, jopartiak dhe jo-fitimprurës.

GLPS është institut i vendosur në Prishtinë, Kosovë. Misioni ynë është që të realizojmë studime profesionale të politikave në fushën e së drejtës, politikës dhe ekonomisë, si dhe të avancojmë orientime politikash që adresojnë dështimet dhe/apo atakojnë problemet në fushat e caktuara.

SHËNIM POLITIKASH 03/2021

RACIONALIZIMI I AGJENCIVE TË PAVARURA RREGULLATORE NË KOSOVË: CILAT JANË OPSIONET?

Autor: Naser Shamolli*

Maj 2021

© Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Maj 2021.

Opinionet e shprehura në këtë dokument jo domosdoshmërisht pasqyrojnë qëndrimet e Grupit për Studime Juridike, donatorët, këshillit, stafit të tyre, apo anëtarëve të bordit. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet apo përdoret në çfarëdo forme pa leje paraprake. Për kërkesa të kësaj natyre kontaktoni zyrën administrative të Grupit për Studime Juridike dhe Politike.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike
Rr. "Rexhep Luci", 16/1
Prishtinë 10 000, Kosovë
Ueb: www.legalpoliticalstudies.org
E-mail: office@legalpoliticalstudies.org
Tel/fax.: +381 38 234 456

*Grupi për Studime Juridike dhe Politike

RACIONALIZIMI I AGJENCIVE TË PAVARURA NË KOSOVË: CILAT JANË OPSIONET?

Hyrje

Procesi i reformimit të agjencive ka filluar qysh në vitin 2016 ku në njërin nga takimet e Grupit të Veçantë të Reformës së Administratës Publike përfaqësuesit e Republikës së Kosovës dhe të Bashkimit Evropian përmes konkluzioneve të përbashkëta u pajtuan që procesi i reformimit të institucioneve dhe i agjencive të cilat i raportojnë Qeverisë dhe Kuvendit është shumë i nevojshëm dhe duhet të filloj sa më parë¹. Pas konkluzioneve, Ministria e Administratës Publike, me mbështetje nga SIGMA/OECD, përgatiti një analizë kualitative dhe kuantitative të titulluar: 'Rishikimi i institucioneve dhe agjencive të pavarura të Kuvendit dhe organeve qendrore të Qeverisë'². Pjesë e kësaj analize ishin edhe Agjencitë e Pavarura Rregullatore (APR), prandaj edhe ky punim do të fokusohet në këto lloje të agjencive duke analizuar vet konceptin dhe bazën ligjore të tyre. Qëllimi i këtij punimi është që të ofrojë një pasqyrë rreth statusit, organizimit dhe funksionimit dhe linjave dhe instrumenteve të llogaridhënies së APR-ve, por edhe opsionet e Qeverisë dhe Kuvendit për reformën e tyre për të cilën duhet të bëhen ndryshime ligjore dhe e cila kërkohet të realizohen këtë vit, sipas ligjit³.

I. DEFINIMI DHE PAVARËSIA E APR-VE

Në aspektin teorik ka mendime të ndryshme rreth definimit të APR-ve të cilat dallojnë si për nga roli ashtu edhe nga tipi i tyre. OECD, lidhur me pyetjen se çfarë janë rregullatorët, të njëjtit i definon si entitete të autorizuara me ligj për të përdorur mjete ligjore për arritjen e objektivave të politikave, dhe vendosjen e kufizimeve dhe ngarkesave përmes funksioneve të dhënies së lejeve, licencave, akreditimit, miratimit, inspektimit dhe përmbarimit⁴.

Në terma të përgjithshëm, autoritetet e pavarura rregullatore (APR) janë vetëm një lloj tjetër i agjencive qeveritare që krijohen përmes delegimit të kompetencave nga politikanë të zgjedhur. Sidoqoftë, ato janë të veçanta për sa i përket funksioneve dhe statusit⁵. Mandati i tyre përfshin funksione të natyrës rregullatore. Ndërsa si aktivitete rregullatore referohen veprimtaritë qeveritare që ndikojnë dhe kontrollojnë sjelljen e individëve dhe bizneseve ose sistemin e rregullave që ndikojnë në një industri ose veprimtari⁶, kompetencat e rregullatorëve, që përfshijnë krijimin e rregullave, dhe mbikëqyrjen dhe rritjen e rregullave⁷.

Pothuajse në të gjitha shtetet Evropiane por edhe në vet Bashkimin Evropian dilemat ngritën rreth pavarësisë së APR-ve dhe se si duhet të sigurohet kjo pavarësi. Kur jemi te pavarësia, parimi i ligjshmërisë përjashton pavarësinë e plotë të çdo organi publik. APR-të nuk përjashtohen nga ky regjim. Së bashku me të gjitha organet e tjera ato duhet të veprojnë brenda kufijve të kornizës së vendosur nga ligjvënësit, d.m.th, në shumicën e vendeve - parlamentit. Pavarësia parlamentare mund të kufizohet nga zotimet kushtetuese dhe ndërkombëtare, por kjo nuk e mohon faktin që legjislatura mbetet kompetente për të frenuar ndjeshëm pavarësinë

¹Takimi i Pestë i Grupit të Veçantë për Reformë të Administratës Publike (konkluzionet) 2 qershor 2016, <https://mpb.rks-gov.net/ap/desk/inc/media/844E0923-6295-4151-BD72-454C2C80932B.pdf>

²Ibid,

³Kuvendi i Kosovës. Ligji nr. 06/l-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, neni 53, paragrafi 1, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18684>

⁴ OECD 201, The Governance of Regulators, OECD Best Practice Principles for Regulatory Policy, OECD Publishing, Paris, 2014

⁵Thatcher, Mark, 2005. The Third Force? Independent Regulatory Agencies and Elected Politicians in Europe,

⁶Beckett, Julia, 2005, Public Management and the Rule of Law.

⁷Bianculli, Andrea C., Fernández-i-Marín, Xavier & Jordana, Jacint, 2013. The World of Regulatory Agencies: Institutional Varieties and Administrative Traditions, Jerusalem Papers in Regulation & Governance.

administrative. Edhe interpretimet më të thelluara të pavarësisë administrative nuk mund të kundërshtojnë këto kompetenca të ligjvënësve. Përndryshe, parimi i ligjshmërisë do të minohej dhe organet e pajisura me pavarësi administrative do të gëzonin përfitimet e saj (autonomia për të përcaktuar objektivat e tyre dhe për t'i ndjekur ato me përdorimin e autoritetit publik) me kontrolle shumë të kufizuara, duke funksionuar gati si biznese private me autoritet publik. Një interpretim i tillë i pavarësisë administrative do të çonte në një përfundim të pakuptimtë që nënkupton kthimin në epokën e para-Rechtsstaat të lirisë administrative, kur kufijtë ligjorë nuk kufizonin veprimet administrative⁸.

Në të drejtën evropiane disa nga direktivat rregullojnë për qëllime të veta statusin e APR-ve por që nuk ka ndonjë rregullim homogjen në këtë aspekt. Formulimi i autoritetit rregullator të APR-ve ndryshon ndërmjet direktivave, por funksionet tipike të rregullatorëve përfshijnë:

- Licencimi dhe shpërndarja e të drejtave të veçanta (p.sh., radio frekuencat) për aktorët e tregut;
- Monitorimi i pajtueshmërisë së operatorëve të tregut me kornizën rregullatore, duke përfshirë shqiptimin e sanksioneve për mospërputhje;
- Kundërveprimi i deformimit ose kufizimit të konkurrencës dhe abuzimit me pozita dominuese nga operatorët në tregjet përkatëse.
- Ndërmarrja e veprimeve për përmirësimin e çasjes të shërbimeve të rregulluara në tregje për grupe të ndryshme të përdoruesve;
- Rregullimi ose miratimi i tarifave (p.sh., për transmetimin ose shpërndarjen e energjisë);
- Shqyrtimi i ankesave të operatorëve të tregut ndaj diskriminimit dhe veprimeve që pengojnë hyrjen në treg ose konkurrencën e ndershme;
- Lëshimi i udhëzimeve detyruese për aktorët e tregut në lidhje me masat specifike që duhet të ndërmerren;
- Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet operatorëve;
- Mbledhja e informacionit nga aktorët e tregut dhe realizimi i analizave të tregut⁹

Në kontekstin tonë, as në teori dhe as në legjislacion, nuk ka ndonjë definim të tillë së paku deri në hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (LOFASHAP). Ky ligj megjithatë bën një definim më të saktë dhe vendos rregulla horizontale sa përket APR-ve sidomos për ato që janë të tipit ekonomik dhe atyre që mbikëqyrin tregun dhe sigurojnë konkurrencën e tregut të lirë të cilat do të shpjegohen më poshtë.

II. BAZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE

APR-të të cilat bëjnë rregullimin e tregut, bazën kushtetuese e kanë tek neni 119, paragrafi 5 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës i cili përcakton se 'Republika e Kosovës do të themelojë organe të pavarura për rregullimin e tregut atëherë kur vetë tregu nuk mundet që në masë të mjaftueshme të mbrojë interesin publik'¹⁰. Nga kjo dispozitë mund të kuptojmë, autorizimin e shprehur kushtetues të shtetit për të themeluar organe të pavarura për rregullimin e tregut.

⁸Szescilo, Dawid, 2021. European Public Law Volume 27, Issue 1 -Challenging Administrative Sovereignty: Dimensions of Independence of National Regulatory Authorities Under the EU Law.

⁹Ibid.

¹⁰Kuvendi i Kosovës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 119, paragrafi 5

Mirëpo ky autorizim kushtëzohet së paku me dy elemente, e para kur tregu nuk mund të vet rregullohet 'mjaftueshëm' dhe e dyta kjo duhet të bëhet për të mbrojtur interesin publik. E dyta, po t'a interpretojmë më gjerë kombinohet së bashku me paragrafin 7 të po të njëjtit nen (neni 119) që lidhet me garancinë kushtetuese për mbrojtjen e konsumatorëve. Pra neni 119 në paragrafët 5 dhe 7 në mënyrë shumë të saktë e rregullon bazën kushtetuese të krijimit të APR-ve duke dhënë hapësirën e nevojshme ligjvënësve për rregullim me ligj të tyre dhe duke mos e kufizuar as në aspektin kohor për ekzistimin/shuarjen e një APR-je por kjo të bëhet çdo herë kur tregu nuk vet rregullohet mjaftueshëm dhe kur kjo rrethanë mund të cenoj interesin publik. Në aspektin e garancisë kushtetuese të konkurrencës së tregut të lirë, neni 10 përcakton se 'Ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës'¹¹.

Aktualisht, bazë ligjore e funksionimit të Agjencive Rregullatore janë kryesisht ligjet e veçanta të cilët kanë rregulluar segmente të caktuara sa i përket statusit të tyre juridik dhe mënyrës së qeverisjes dhe organizimit, vijave të llogaridhënies dhe raportimit por pa ndonjë konsistencë dhe kornizë të përbashkët logjike.

Ndër vite, themelimi i APR-ve në Kosovë është bërë kryesisht pa ndonjë kriter dhe jo gjithëherë mbi bazën e nenit 119 të kushtetutës, duke i dhënë epitetin e rregullatorit edhe disa agjencive e që nuk janë të tilla (Rasti i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, Komisionit të Minerave dhe Mineraleve) ose së paku ka munguar autorizimi ligjor për rregullim të tregut apo mbikëqyrjen e operatorëve të tregut. Rasti tjetër ka të bëjë me disa APR që kanë kompetenca në rregullimin e tregut por që aktor në treg është vetëm shteti përmes ndërmarrjeve publike (sikurse Agjencia Rregullatore e Hekurudhave dhe Autoriteti i Aviacionit Civil).

2.1. Statusi ligjor i APR-ve sipas LOFASHAP

Si ligj me fushëveprim horizontal që rregullon në mënyrë homogjene mënyrën e krijimit, organizimin, funksionimin dhe llogaridhënien e APR-ve është LOFASHAP i cili ka hyrë në fuqi me 1 prill 2019.

Bazuar edhe në praktikën e mira të OECD-së, LOFASHAP, APR-të i përcakton si agjenci që bëjnë rregullimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së operatorëve të një tregu të caktuar me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve dhe sigurimit të konkurrencës së lirë. Nga kjo kuptohet se neni 14 i LOFASHAP sa i përket APR-ve në fakt është zgjatim i rregullimit kushtetues të përcaktuar në nenin 119, paragrafi 5 dhe 7 dhe neni 10 të kushtetutës. Sa i përket instrumentit të themelimit të njëjtat mund të themelohen vetëm me ligj, pra nga Kuvendi i Kosovës¹².

Për nga statusi i tyre, APR-të përcaktohen si agjenci rregullatore që janë pjesë e administratës shtetërore duke u renditur bashkë me sistemet ministrore dhe Zyrën e Kryeministrit¹³. Se çka nënkuptohet administratë shtetërore e njëjta përcaktohet si aparati organizativ dhe profesional i Qeverisë, që i shërben interesit publik nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të politikave¹⁴. Nga këto rregulla kuptohet pikësepari se APR-të janë pjesë e administratës shtetërore në njërin anë, por që statusi i tyre dallohet nga agjencitë e tjera duke ju dhënë pozitën e njëjtë me Zyrën e Kryeministrit dhe vet sistemet ministrore në anën tjetër.

LOFASHAP shumë qartë bën dallimin edhe në mes të dy tipeve të agjencive që janë Agjencitë e Pavarura dhe Agjencitë Ekzekutive. Dallimi në mes të Agjencive Rregullatore dhe

¹¹Ibid, neni 10

¹² Kuvendi i Kosovës. Ligji nr. 06/l-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, neni 14, paragrafi 2, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18684>,

¹³Ibid, neni 9 paragrafi 1,

¹⁴Ibid, neni 8 paragrafi 1

Agjencive të pavarura qëndron si në funksione poashtu edhe tek statusi i tyre. Agjencitë e Pavarura mund të krijohen me ligj nga Kuvendi nën kushtin që të njëjtat nuk mund të ushtrojnë kompetenca të pushtetit ekzekutiv që i garantohen Qeverisë me Kushtetutë dhe të njëjtat i shërbejnë Kuvendit për ushtrimin e mbikëqyrjes/kontrollit parlamentar të specializuar të ligjshmërisë dhe integritetit në fusha të caktuara të veprimtarisë administrative përderisa Agjencitë Rregullatore themelohen në kuadër të administratës shtetërore në ushtrimin e funksioneve që kanë të bëjnë me rregullimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së operatorëve të një tregu të caktuar me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve dhe sigurimit të konkurrencës së lirë. Dallimi tjetër është në mes Agjencive Rregullatore dhe Agjencitë Ekzekutive ku edhe në këtë rast këto agjenci dallojnë si për nga statusi edhe për nga funksionet që i kanë. Përderisa Agjencitë Rregullatore janë pjesë e administratës shtetërore dhe kanë status gati të njëjtë me Zyrën e Kryeministrit dhe të një ministrie, Agjencitë Ekzekutive janë pjesë e sistemit ministror (e një ministrie). Kur jemi tek funksionet, përderisa Agjencitë Rregullatore kanë funksione të rregullimit dhe mbikëqyrjes së veprimtarisë së operatorëve të një tregu të caktuar me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve dhe sigurimit të konkurrencës së lirë, Agjencitë Ekzekutive ushtrojnë këto funksione:

- zbatimin e ligjit, duke zgjidhur çështje individuale dhe duke kryer veprime administrative sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative;
- mbledhjen e tatimeve, taksave, detyrimeve doganore, kontributeve apo detyrimeve të tjera dhe menaxhimin e tyre për qëllimin për të cilin janë krijuar;
- mbrojtjen e sigurisë publike nëpërmjet ushtrimit të autorizimeve policore, dhënien e lejeve, licencave, autorizimeve dhe miratimeve për veprimtari ekonomike specifike dhe kryerjen e inspektimeve;
- mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave dhe informacionit për Qeverinë;
- ushtrimin e përbashkët të funksioneve të brendshme mbështetëse.

2.2. Qeverisja e APR-ve

LOFASHAP vendos rregulla për qeverisjen e APR-ve. Në këtë aspekt, si rregull APR udhëhiqet nga Drejtori mirëpo përjashtimisht mund të udhëhiqet nga një organ kolegjal. Nga ky rregullim shihet mundësia që duke ditur natyrën dhe kompleksitetin e APR-ve, LOFASHAP i jep liri që me ligj të themelimit të bëhet edhe përcaktimi se cila formë është më e përshtatshme për qeverisjen e tyre. Përzgjedhja e secilës formë duhet analizohet dhe argumentohet për nga aspekti i sigurimit të pavarësisë së tyre në ushtrimin e funksioneve për të përmbushur sa më mirë interesin e përgjithshëm në njërin anë dhe cila formë e qeverisjes do të ishte më përshtatshme për të siguruar llogaridhënie më efikase. Sa i përket procedurës së përzgjedhjes si të drejtorit ashtu edhe të anëtarit të organit kolegjal (kur përcaktohet me ligj të veçantë kjo formë qeverisje) do të vlejné rregullat e njëjta si në përzgjedhjen e nivelit të lartë drejtues në shërbimin civil (si p.sh pozita e Sekretarit të Përgjithshëm) të përcaktuara në Ligjin për Zyrtarët Publik (LZP). Drejtori dhe anëtarët e organit kolegjal e kanë statusin e funksionarit publik me status të veçantë sipas LZP¹⁵ prandaj rregullimi i procedurës është 'huazim' nga LZP dhe në asnjë rast nuk e bën drejtorin dhe anëtarët e organit kolegjal të kenë statusin e Zyrtarit Publik. Sa i përket organit që bën emërimin e drejtorit apo organit kolegjal, si rregull, emërimin e bën Qeveria mirëpo me ligjin e themelimit mund të përcaktohet se emërimin mund ta bëj edhe Kuvendi sipas detyrës zyrtare

¹⁵ Kuvendi i Kosovës. Ligji nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, neni 3 paragrafi 3.6

apo me propozim të Qeverisë. Mandati i drejtorit dhe anëtarit të organit kolegjal do të jetë 4 vjet me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat tjetër. Përveç përfundimit të rregullt, mandati mund të përfundoj edhe para kohe nëse plotësohen këto kushte:

- mosparaqitjen, brenda afatit, në Qeveri të Planit Vjetor të Përformancës apo Raportit Vjetor të Përformancës;
- mosmiratimin nga Qeveria të Raportit Vjetor të Performancës për dy (2) vjet radhazi;
- shkelje të rënda të ligjit;
- mungesë e rëndë e integritetit apo veprime në konflikt interesi me detyrën zyrtare;
- kufizimit apo heqjes së zotësisë për të vepruar, me vendim të formës së prerë;
- dënimit me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- me arritjen e moshës së pensionimit¹⁶.

Autorizimin ligjor për përfundimin e parakohshëm të mandatit e kanë organet që bëjnë përzgjedhjen e drejtorit/anëtarit të organit kolegjal. Duke parë kompleksitetin dhe llojllojshmërinë e APR-ve, LOFASHAP nuk ka përcaktuar kritere për tu zgjedhur drejtor/anëtar i organit kolegjal i APR-së, por kjo duhet të rregullohet me ligjin e themelimit.

Funksionet e organit menaxhues të APR-ve janë të njëjta si të drejtorit ekzekutiv të një agjencie ekzekutive por që dallojnë tek kapaciteti normativ i tyre sepse te njëjtat kanë të drejtën e nxjerrjes së vendimeve me karakter rregullator.

2.3. Sistemi i llogaridhënies dhe vlerësimit të përformancës së APR-ve

LOFASHAP për herë të parë vendos rregulla horizontale për sa i përket vijave të llogaridhënies, mbikëqyrjes dhe vendosjes së sistemit të përformancës duke përcaktuar organet përgjegjëse, planin dhe raportin e përformancës. Drejtimi dhe mbikëqyrja e një agjencie rregullatore bëhet nëpërmjet sistemit të menaxhimit të përformancës dhe instrumenteve specifike të mbikëqyrjes e cila është përgjegjësi e Qeverisë dhe ushtrohet përmes ministrit përgjegjës i cili vepron si njësi përgjegjëse.

Sistemi i menaxhimit të përformancës përbëhet nga plani i përformancës i cili hartohet nga APR dhe përmban së paku këto elemente:

- kuadrin logjik, që përcakton objektivat, produktet dhe rezultatet specifike për t'u arritur, të kombinuar me treguesit e performancës, indikatorët dhe detyrat përkatëse,
- pjesën financiare, që specifikon buxhetin e agjencisë dhe shpërndarjen e tij sipas rezultateve specifike për t'u arritur.

Përmbajtja e planit të përformancës është rregulluar detajisht me Rregulloren Nr. 03/2020 për Përformancën e Agjencive¹⁷.

Plani i përformancës dakordohet në mes APR dhe njësisë përgjegjëse deri më 30 nëntor të vitit ekzistues, për vitin pasues. Nëse nuk ka dakordim në mes të njësisë përgjegjëse, plani përformancës miratohet nga Qeveria deri 31 dhjetor të vitit, për vitin pasues.

Raporti i përformancës dërgohet tek njësia përgjegjëse jo më vonë se më 31 Mars të vitit pasardhës dhe përmban informacionet e detajuara mbi arritjen e objektivave, produkteve dhe rezultateve të përcaktuara në planin e përformancës. Njësia përgjegjëse fillon një proces dialogu

¹⁶Kuvendi i Kosovës. Ligji nr. 06/l-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, neni 24, paragrafi 6, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18684>

¹⁷ Rregullorja (QRK) Nr. 03/2020 për Përformancën e Agjencive <https://gzk.rksgov.net/ActDetail.aspx?ActID=27050>

rreth përmbushjes së objektivave i cili përfundohet brenda 30 ditëve pas paraqitjes së raportit. Sipas rezultatit të dialogut të performancës njësia përgjegjëse përgatit deklaratën e performancës vjetore të APR e cila i ofrohet për miratim Qeverisë. Deklarata e performancës përfshin miratimin apo mosmiratimin e raportit të performancës dhe një vlerësim të performancës dhe fushat specifike në të cilat është e nevojshme të ndryshoj performanca e agjencisë¹⁸.

Plani, raporti dhe deklarata e performancës duhet të bëhen publike në webfaqen e APR-s përkatëse

Përveç sistemit të menaxhimit të performancës, për APR-të ekzistojnë edhe instrumentet specifike të mbikëqyrjes. Sipas LOFASHAP, njësia përgjegjëse nga APR mund të ushtroj këto instrumente specifike të mbikëqyrjes, duke kërkuar:

- të kërkojë informacion dhe dokumente lidhur me punën e agjencisë;
- të ndërmarrë inspektime lidhur me ligjshmërinë, efektivitetin dhe eficiencën e punës së agjencisë¹⁹.

Nga edhe vet cilësimi pra këto janë instrumente specifike që ka në dorë Njësia Përgjegjëse ndaj APR, si në sigurimin e informacionit dhe dokumenteve ashtu edhe tek veprimet për të kryer inspektime sa i përket ligjshmërisë dhe efektivitetit dhe eficiencës së agjencisë. Megjithatë e drejta e përdorimit të inspektimit në asnjë rast nuk nënkupton përfshirjen e njësive përgjegjëse dhënien e urdhrave dhe udhëzimeve për çështje konkrete administrative e që janë kompetencë e vet APR-së. Për aktet rregullatore që i nxjerr APR si rregull mund të ngrihet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështje administrative.

III. GJENDJA AKTUALE, STATUSI JURIDIK, QEVERISJA, LLOGARIDHËNIA

Fillimisht duhet bërë të qartë se ky raport është fokusuar vetëm në APR-të të cilat kanë kompetenca në rregullimin dhe mbikëqyrjen e një tregu të caktuar dhe jo në disa tipe institucionesh që kanë emrin dhe funksionojnë si APR por që në fakt nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara në LOFASHAP për të pas këtë status. Pra fokusi jonë do të jetë tek këto APR që bëjnë rregullimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së operatorëve të një tregu të caktuar me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve dhe sigurimit të konkurrencës së lirë. Të kësaj natyre janë identifikuar agjencitë e paraqitura në shtojcën 1 të këtij raporti. Nga ajo që është analizuar në aspektin e krijimit të këtyre agjencive për secilën ekziston baza e qartë ligjore, pra ato janë të themeluara me ligj. Qeverisja e tyre ndryshon kryesisht në mes qeverisjes kolegjiale dhe asaj individuale (vetëm ARRU ka qeverisje individuale të tjerat kanë kolegjiale). Kur jemi te qeverisja kolegjiale prap e njëjta dallon në mes të një bordi menaxhues dhe të një bordi mbikëqyrës (bordi mbikëqyrës ekziston tek ARRH dhe AACK). Sa i përket kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për të qenë drejtor ose/apo anëtar i një bordi, ligjet respektive janë shumë të mangëta dhe të përgjithshme, në shumicën e rasteve kërkohet një diplomë universitare dhe 3 e në disa raste 7 vite përvojë pune. Kur jemi tek përbërja e bordeve për të qenë anëtar p.sh kërkohet lloji i diplomës juridik, ekonomi dhe degë të tjera që lidhen me natyrën e APR, mirëpo nuk ka ndarje të tipit p.sh që nga 5 anëtar një duhet me qenë jurist dhe një ekonomist dhe të tjerët të fushës përkatëse të APR. Në mungesë të këtij rregullimi në praktikë mund të ndodhë që gjithë përbërja të jetë e një specializimi të caktuar por që nuk është relevant me APR konkrete (p.sh të gjithë

¹⁸Kuvendi i Kosovës. Ligji nr. 06/l-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, neni 30, paragrafi 6, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18684>

¹⁹Ibid, neni 32 paragrafi 1

juristë ne ARKEP). Tjetër problem që ekziston tek përbërja e bordeve është se ato kanë përbërje e cila emërohet vetëm nga Qeveria ose Kuvendi sipas rastit dhe nuk ka përfaqësim për shembull të shoqatave profesionale, mbrojtëseve të drejtave të konsumatorëve etj. Emërimi drejtorit/anëtarëve bëhet në disa raste nga Qeveria në disa tjera nga Kuvendi (ex-officio apo me propozim të Qeverisë). Procedurat e emërimit në përgjithësi mungojnë, por edhe aty ku ekzistojnë nuk japin ndonjë garanci që siguron meritën dhe profesionalizmin e këtyre trupave. Kushtet minimale për të qenë drejtor/anëtar bordi, përbërja e njëanshme e bordeve dhe mungesa e procedurave të bazuar në konkurrencë e transparencë e ka bërë të përshtatshme që drejtor/anëtar të bordeve të jenë persona të afërt me politikën ditore dhe militant partiak.

Sa i përket llogaridhënies, në përgjithësi nuk ka ndonjë rregullim të qartë dhe të saktë si në aspektin e organeve përgjegjëse për mbikëqyrje ashtu edhe për nga mekanizmat dhe instrumentet e mbikëqyrjes. Nuk ka ndonjë kërkesë ligjore që të hartohen dhe miratohen plane të performancës e as indikator matës për vlerësimin e saj. Format e mbikëqyrjes nuk janë të definuara nëse janë të drejtpërdrejta apo të tërthorta. Mbikëqyrja e drejtpërdrejte në shumicën e rasteve ushtrohet tek Kuvendi ose tek komisionet përgjegjëse të Kuvendit në të cilat mungon specializimi për të sfiduar një APR, fushëveprimi i të cilave është shumë kompleks dhe kërkon specializim të thelluar, i cili mungon tek komisionet funksionale por edhe tek vet administrata e Kuvendit. Kur jemi tek mbikëqyrja e tërthortë në disa APR ekziston bordi mbikëqyrës por që i njëjti ka përbërje homogjene (të gjithë anëtarët emërohen nga Kuvendi ose Qeveria sipas rastit) dhe nuk ka përfaqësim në bord të pjesëmarrësve tjerë për të minimizuar ndikimin politik të mundshëm dhe për të përforcuar llogaridhënien e tyre.

Vetëm në disa raste rregullohet përmbajtja e raportove por e cila është e orientuar më shumë rreth raportimit përshkruar të aktiviteteve të zakonshme se sa raportim i bazuar në performancë dhe në arritjen e produkteve konkrete të APR-së. Pasojat e mungesës së raportit dhe raportit negativ të performancës përveç tek ZRRE nuk rregullohen që nënkupton se nëse raporti nuk paraqitet ose performanca është negative nuk ka ndonjë pasojë për organin menaxhues të APR (drejtorin/bordin).

IV. OPSIONET E REFORMËS SË APR-VE

Pyetja e shpeshtë që bëhet dhe që është edhe sfidë edhe e hartuesve të legjislacionit të APR-ve është se si duhet rregulluar rregullatorët prandaj gjatë procesit të reformave dhe hartimit të legjislacionit duhet pas parasysh këto pika reformuese:

- reduktimi i numrit të institucioneve rregullatore në një juridiksion të vetëm dhe mënjanimi i ndikimit politik në borde duke ndaluar nominimin e politikanëve në bordet e institucioneve rregullatore financiare;
- buxheti i institucionit duhet të jetë komplet i pavarur nga qeveria në të dy anët si për nga aspekti i buxhetimit ashtu edhe për nga mënyra e shpenzimit,
- që të stimulohen rregullatorët për të rregulluar në kohë krize, duhet të miratohen mekanizmat e pensionit të parakohshëm për rregullatorët,
- diversifikimi i bordit të drejtorëve të institucioneve rregullatore duke përfshirë edhe përfaqësues nga publiku dhe ekspertët në bordin menaxhues. Për më tepër, dy llojet e drejtorëve të institucionit rregullator (si organ individual ose edhe kur janë pjesë e bordit) dhe vetë rregullatorët duhet t'i nënshtrohen detyrave të kujdesit dhe besnikërisë,
- përveç komiteteve të auditimit dhe shpërbllimit, duhet të futet rishikimi i kolegëve nga rregullatorë të sektorit të ngjashëm nga vendet e tjera,

- punësimi i ish nëpunësve të institucionit rregullator financiar duhet të kufizohet në mënyrë që të shmangët kapja dhe konflikti i padëshiruar i interesave,
- qëllimet e autoritetit rregullator financiar duhet të përcaktohen qartë me ligj dhe informimi më i zyrtarizuar dhe i gjerë e publik i punës rregullatore duhet të kryhet mirë²⁰.

Duke marrë parasysh rregullimin që është bërë në LOFASHAP si dhe kërkesën ligjore që procesi i reformës/përshtatjes së statusit të agjencive, ekzekutive, rregullatore dhe të pavarura duhet të bëhet deri në fund të vitit 2021²¹, ky punim ka për qëllim që të ofroj disa opsione se si mund të bëhet reforma APR-ve (shtojca 2) si në aspekt të optimalizimit të tyre (zvogëlimit të numrit të tyre) ashtu edhe në përshtatjen e statusit, mënyrës së qeverisjes dhe llogaridhënies.

4.1. Zvogëlimi i numrit të APR-ve - duhet konsideruar, marrë parasysh reformën e gjithmbarshme në reduktimin e ministrive dhe agjencive në përgjithësi e cila ka filluar të zbatohet në Kosovë. Kur jemi te zvogëlimi i APR-ve duhet konsideruar këto opsione:

4.1.1. Opsioni 1, nga 7 APR krijohet një e vetme por duke lënë jashtë Komisionin e Pavarur të Medieve meqenëse i njëjti ka status kushtetues (këtë sistem e kanë Holanda, Spanja, Latvia dhe Gjermania). Kjo APR do të funksiononte në degën e ekzekutivit. Ky opsion do të optimalizonte në aspektin financiar shumë shpenzime duke përfshirë një organ kolegjal të vetëm, shërbimet e përbashkëta, shpenzime të përbashkëta etj.

4.1.2. Opsioni 2, bashkimi i APR-ve duke pas parasysh specializimin e sektorëve. Sipas këtij opsioni do të krijoheshin një APR që përfshinë rregullimin e aviacionit civil, hekurudhave, komunikimet elektronike dhe postare, një APR që përfshinë rregullimin e ujit dhe kanalizimit, energjisë, mbeturinave, një APR për konkurrencë dhe Komisioni i Medieve të Pavarura. Pra nga 7 sa janë do të reduktoheshin në 4 sosh. Në këtë opsion, Komisioni i Konkurrencës ruan statusin e APR-ve por duhet të ndryshohen linjat e llogaridhënies dhe elementet e tjera në ligjin e tyre për t'i harmonizuar me LOFASHAP.

4.2. Qeverisja e APR-ve-LOFASHAP duke parë kompleksitetin dhe llojllojshmërinë e APR-ve ka lënë të hapur mundësinë e qeverisjes së APR-ve në mes të një qeverisje kolegjiale dhe individuale. Mënyrë e qeverisjes duhet rregullohet me ligj të veçantë dhe secili përcaktim (kolegjial ose individuale) duhet të mendohet mire dhe në mënyrën që sa më mirë t'i shërbej interesit të përgjithshëm dhe vendosjes së linjave të qarta të llogaridhënies. Edhe tek qeverisja për secilën opsion që zgjidhet japim këto rekomandime.

4.2.1. Qeverisja përmes një organi kolegjal duhet shikuar nga shumë perspektiva. Fillimisht duhet të përcaktohet përbërja dhe procedura e zgjedhjes së anëtarëve të bordit të bazohet në konkurrencë dhe meritë. Kur jemi te madhësia e organit kolegjal duhet konsideruar numrin nga 3 deri në 7 anëtar. Përbërja e organit kolegjal duhet pasqyroj edhe pjesëmarrës nga shoqatat profesionale dhe përdoruesit e shërbimit të caktuar. Kriteret e shkollimit dhe përvojës duhet të jenë të qarta. Lloji i shkollimit dhe përvojës duhet të balancohet duke përcaktuar natyrën dhe funksionet e APR (p.sh njëri nga anëtarët e bordit duhet të ketë fakultetin juridik dhe përvojën në fushën e shkollimit). Procedura e zgjedhjes, mandati dhe shkaqet e shkarkimit janë përcaktuar në LOFASHAP, prandaj të njëjtat mund të huazohen në ligjin e veçant ose ligji i

²⁰Jabotinsky, Hadar and Siems, Mathias, 2017. How to Regulate the Regulators: Applying Principles of Good Corporate Governance to Financial Regulatory Institutions https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2978112.

²¹Kuvendi i Kosovës. Ligji nr. 06/l-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, neni 53, paragrafi 1, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18684>

veçantë të bëjë referencë në LOFASHAP. Kur jemi te organi që bënë emërimin dhe shkarkimin, si rregull sipas LOFASHAP emërimi bëhet nga Qeveria me propozim të ministrisë përgjegjëse për fushën e APR-së. Mundësia tjetër është që me ligjin e themelimit emërimi mund të bëhet direkt nga Kuvendi i cili vet zhvillon procedurat e përzgjedhjes ose me propozim të Qeverisë e cila bënë përzgjedhjen ndërsa emërimi bëhet nga Kuvendi. Nëse me ligj të veçantë zgjidhet mënyra e emërimit nga Kuvendi, kujdes të veçantë duhet t`i kushtohet komisioneve përzgjedhëse si në rastin kur ato krijohen nga Kuvendi ashtu edhe kur ato krijohen nga Qeveria. Një tjetër aspekt që duhet analizuar mirë është sistemi i menaxhimit financiar dhe burimeve njerëzore që prap janë dy mundësi që kjo të bëhet nga vet bordi përmes kryetarit të tij apo nga një Sekretar i Përgjithshëm i cili siguron profesionalizmin dhe vazhdimësinë e kujtesës institucionale. Për punën, procedurën dhe vendimmarrjen e organit kolegjal rregullimi mund të huazohet nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative. Organi që zhvillon procedurën e pranimit të drejtorit/anëtarit të bordit duhet të përcaktohet shprehimisht me ligj dhe duhet të ketë specializimin e nevojshëm në burime njerëzore (p.sh mund të autorizohet Departamenti për menaxhimin e zyrtarëve publik për zhvillimin e procedurës dhemenaxhimin dhe ruajtjen e dosjeve të anëtarëve të bordit). Kriteret e emërimit duhet të përcaktohen me ligjin e veçantë të APR dhe të njëjtat duhet sigurojnë profesionalizëm.

4.2.2. Qeverisja përmes një organi individual (monokratik)/Drejtori të APR është më e thjeshtë për nga perspektiva e përzgjedhjes dhe shkarkimit. Komplet procedura e përzgjedhjes, mandati, shkaqet e shkarkimit janë të përcaktuara në LOFASHAP. Kriteret e emërimit duhet të përcaktohen me ligjin e veçantë të APR dhe të njëjtat duhet sigurojnë profesionalizëm. Si edhe tek qeverisja kolegjiale, duhet të përcaktohet nëse menaxhimi financiar dhe i burimeve njerëzore bëhet direkt nga Drejtori apo nga një Sekretar i Përgjithshëm. Tek mënyra e qeverisjes individuale duhet marrë parasysh një segment shumë me rëndësi që ka të bëjë me delegimin e kompetencave, prandaj edhe ligji i veçantë nuk duhet të koncentroj të gjithë autoritetin (administrativ) tek Drejtori por tek vet APR në mënyrë që pastaj drejtori të përzgjedh dhe përcaktoj strukturat përgjegjëse profesionale për ushtrimin e këtij autoriteti në mënyrë profesionale. E njëjta nuk ndodh me autoritetin rregullativ prandaj kjo kompetencë duhet të mbet si kompetencë e Drejtorit të APR.

4.3. Kapaciteti normativ i APR- është njëri nga funksionet kryesore të një APR prandaj duhet pas kujdes si për nga natyra e aktit që rregullon tregun ashtu edhe për nga procedura dhe organi që bënë miratimin. Akti që rregullon tregun e caktuar (p.sh përcaktimi i tarifave) ka elemente më shumë të aktit nënligjor normativ prandaj ligji i veçantë duhet të parashikoj kushtet dhe kufizimet se çka edhe deri në sa duhet të rregulloj akti nënligjor, procedurën dhe autoritetin e miratimit. Procedura e hartimit dhe konsultimit duhet t`i nënshtrohet procedurës standarde të konsultimit paraprak dhe publik si për çdo akt tjetër normativ.

4.4. Buxheti i APR- Sa i përket menaxhimit financiar duhet të vlejnjë rregullat e përgjithshme që rregullojnë këtë fushë, përpos që APR duhet të kenë kod të veçantë buxhetor të përcaktuar në ligjin vjetor të buxhetit. Duke marrë parasysh se buxheti është një nga segmentet për ruajtjen e pavarësisë rekomandohet që buxheti të propozohet direkt në Kuvend pa pas nevojë për një miratim paraprak nga Qeveria.

4.5 Organizimi i brendshëm-i përcaktuar në LOFASHAP duhet të zbatohen edhe në rastin e APR-ve. Menaxhimi i burimeve njerëzore duhet të bëhet nga vet APR ndërsa nëpunësitë APR-së duhet të kenë statusin e nëpunësit të shërbimit civil në pajtim me Ligjin për Zyrtarët Publik.

4.6.Llogaridhënia-rregullimet e përcaktuara në LOFSHAP për llogaridhënien duhet të zbatohen drejtpërdrejt në çdo APR. Megjithatë me ligj te veçantë ky rregullim duhet të shprehet p.sh duke bërë referencë në LOFASHAP.

E gjitha reforma e APR-ve ka implikim direkt në plotësimin dhe ndryshimi e ligjeve të veçanta prandaj kjo mund të bëhet përmes një ligji të vetëm i cili i plotëson të gjitha ligjet e veçanta të APR-ve ose duke bërë ndryshime një nga një në secilin ligj. Deri në plotësimin dhe ndryshimin e ligjeve të veçanta rregullimet e parashikuara në LOFASHAP e që nuk janë tek ligjet e veçanta duhet të zbatohen drejtpërdrejt në pajtim me nenin 53 paragrafi 2 të LOFASHAP.

SHTOJCA 1 - Gjendja Aktuale e APR-ve

Agjencia	Baza Ligjore	Qeverisja	Raportimi	Llogaridhënia
Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit	Ligji Nr. 05/L - 042 për rregullimin e shërbimeve të ujit	Drejtor Propozohet dhe zgjedhet nga Kuvendi.	Kuvend	Planifikimi: Nuk kërkohet plan performance sipas ligjit. Raporti, përmbajtja: aktivitetet operative dhe financiare të Autoritetit të kryera gjatë vitit paraprak, duke përfshirë të dhënat të hollësishme të treguesve të punës për secilin sektor të rregulluar sipas këtij ligji dhe llogaritë e konsoliduar financiare të Autoritetit për vitin paraprak. Pasoja juridike: nuk ka ndonjë pasojë juridike për Drejtorin nëse plani apo raporti i performancës nuk miratohen.
Zyra e Rregullatorit për Energji	Ligji Nr. 05/L-084 për rregullatorin e energjisë	Bord+drejtor menaxhues Kushtet për emërimin e anëtarëve të bordit: Caktohen me ligj dhe janë minimale. Përbërja dhe mënyra e zgjedhjes së Bordit: Anëtarët e bordit propozohen nga ministria, miratohen në Qeveri dhe emërohen përfundimisht nga Kuvendi. Nuk ka ndarje në aspekt të përfaqësimit. Drejtori menaxhues: nuk ka rregulla	Kuvend përmes komisionit përgjegjës funksional	Plani: Nuk kërkohet plan performace Raporti, përmbajtja : detyrimi për raportim përcaktohet me ligj. Raporti përmban: -rezultatet e monitorimit të konkurrencës dhe transparencës në tregjet e energjisë, - përmbledhjen e të gjitha vendimeve individuale të ndërmarra dhe vendimet mbi zgjidhjen e kontesteve dhe procedurat përbarimore të ndërmarra nga Rregullatori gjatë vitit paraprak; - të dhënat mbi licencimin dhe aktivitetet tjera rregullative gjatë vitit paraprak; raportin e audituar financiar të Rregullatorit për vitin paraprak, përfshirë këtu shumën e të hyrave të mbledhura nga Rregullatori si dhe shpenzimet e bëra Pasoja juridike: Kuvendi i Kosovës mund të inicioj procedurën e shkarkimit të Kryetarit dhe anëtarëve të bordin nëse dy vjet radhazi kanë dështuar

		se si zgjidhet dhe cili është mandati dhe funksioni i tij.		përbushjen e plotë të përgjegjësive e cila ka dëmtuar seriozisht efikasitetin e sektorit të energjisë.
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	Ligji Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës	<p>Bord Mbikëqyrës(jo ekzekutiv)+Drejtori i Përgjithshëm</p> <p>Kushtet për emërimin e anëtarëve të bordit:</p> <p>Caktohen me ligj dhe janë minimale.</p> <p>Përbërja dhe mënyra e zgjedhjes së Bordit: Rekomandohet nga ministria, miratohen në Qeveri dhe emërohet nga Kuvendi. Nuk ka ndarje në aspektin e përfaqësimit.</p> <p>Drejtori menaxhues: është njëri nga anëtarët e bordit, zgjedhet nga Bordi sipas legjislacionit të shërbimit civil.</p> <p>Funksionet e Drejtorit të Përgjithshëm: delegohen nga bordi edhe pse i njëjti është jo ekzekutiv, dhe nga ligji i hekurudhave.</p>	Kuvendit	<p>Plani: Nuk kërkohet plan përformance</p> <p>Raporti, përmbajtja: Nuk rregullohet me ligj</p> <p>Pasojat juridike: nuk ka ndonjë pasojë juridike për bordin dhe Drejtorin nëse plani apo raporti i përformancës nuk miratohen.</p>
Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare		<p>Bord</p> <p>Kushtet për emërim:</p> <p>Caktohen me ligj dhe janë të përgjithshme.</p> <p>Përbërja dhe mënyra e zgjedhjes së Bordit: Rekomandohet nga ministria, propozohet nga Qeveria dhe emërohet nga Kuvendi. Nuk ka ndarje në</p>	Kuvend	<p>Plani: Nuk kërkohet plan përformance</p> <p>Raporti, përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none"> -raportin e punës së Autoritetit për vitin paraprak; -programin vjetor të punës për vitin në vazhdim; -raportin për statusin e shërbimit universal; -raportin për realizimin e treguesve financiarë vjetorë të Autoritetit;

		<p>aspektin e përfaqësimit.</p> <p>Drejtori menaxhues: Nuk ka, këtë funksion e ushtron Kryetari I Bordit</p>		<p>-të dhënat për gjendjen në tregun e komunikimeve elektronike.</p> <p>Pasojat juridike: nuk ka ndonjë pasojë juridike për bordin.</p>
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	Ligji Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës	<p>Komision+Drejtore të Përgjithshëm</p> <p>Kushtet për emërim të anëtarëve:</p> <p>Caktohen me ligj dhe janë të përgjithshme dhe minimale.</p> <p>Përbërja dhe mënyra e zgjedhjes së Bordit: Nga Qeveria dhe emërohen nga Kuvendi. Nuk ka ndarje për nga aspekti i përfaqësimit.</p> <p>Drejtori përgjithshëm: Nuk ka rregulla se si rregullohet statusi, mënyra e përzgjedhjes e as funksionet e tij.</p>	Kuvendi	<p>Plani: Nuk kërkohet plan performancë</p> <p>Raporti, përmbajtja: Nuk rregullohet me ligj</p> <p>Pasojat juridike: nuk ka ndonjë pasojë juridike për anëtarët e komisionit nëse nëse plani apo raporti i performancës nuk miratohen.</p>
Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës	Ligji Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil	<p>Bord Mbikëqyrës (jo ekzekutiv)+Drejtori I Përgjithshëm</p> <p>Kushtet për emërim:</p> <p>Caktohen me ligj dhe janë minimale.</p> <p>Përbërja dhe mënyra e zgjedhjes së Bordit: Rekomandohet nga ministri, emërohen nga Qeveria. Nuk ka ndarje</p>	Drejtori i Përgjithshëm, Bordi, ministria, Qeveria dhe Kuvendi	<p>Plani: Nuk kërkohet plan performancë</p> <p>Raporti përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> -siguron informata të hollësishme për vitin e shkuar kalendarik lidhur me; -organizimin, veprimtaritë, personelin dhe nivelin e rrogave të AAC: -prokurimet, menaxhimin financiar dhe çështjet buxhetore të AAC: -të gjitha ankesat administrative, kontestet (konfliktet) dhe procedurat e paraqitura ose të zhvilluara gjatë vitit të shkuar kalendarik; dhe

		<p>në aspektin e përfaqësimit.</p> <p>Drejtori menaxhues: Emërohet nga Qeveria me propozim të ministrit. Përveç disa kushteve minimale dhe të përgjithshme nuk kërkohet konkurrencë dhe meritë gjatë procesit të përzgjedhjes.</p>		<p>-të gjitha vendimet dhe masat mbi çështjet ekzekutive, rregullore ose të licencimit të AAC.</p> <p>Pasojat juridike: nuk ka ndonjë pasojë juridike për Drejtorin e Përgjithshëm nëse raporti nuk miratohet.</p>
Komisioni i Pavarur i Medieve	<p>Neni 141 i Kushtetutës dhe Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Medieve</p>	<p>Komision+Kryeshef Ekzekutiv</p> <p>Kushtet për emërim të anëtarëve:</p> <p>Caktohen me ligj dhe janë të përgjithshme dhe minimale.</p> <p>Përbërja dhe mënyra e zgjedhjes së Bordit: Anëtarët zgjedhen nga Kuvendi përmes një procedure të hapur dhe transparente. Nuk ka ndarje për nga aspekti i përfaqësimit.</p> <p>Kryeshefi Ekzekutiv: emërohet sipas legjislacionit të shërbimit civil.</p>	Kuvend	<p>Plani: Nuk kërkohet plan performace</p> <p>Raporti, përmbajtja: Me ligj rregullohet vetëm detyrimi për të raportuar në Kuvend por jo edhe përmbajtja.</p> <p>Pasojat juridike: nuk ka ndonjë pasojë juridike për anëtarët e komisionit nëse plani apo raporti i performancës nuk miratohen.</p>

SHTOJCA 2- Opsionet Reformuese të APR-ve

Agjencia	Zvogëlimi numrit		Funksionet	Qeverisja		Buxheti	Organizimi i brendshëm	Llogaridhënia
	Ops.1	Ops.2		Ops.1	Ops.2			
Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit	Bashkim	Bashkim	Duhet shtuar edhe funksionet e rregullimit të mbeturinave dhe depove të mbeturinave	Q. kolegjiale Bord me 3-7 anëtar	Q. individuale Drejtor	Buxheti: kodi i veçantë buxhetor, propozimi i buxhetit të bëhet direkt në Kuvend.	Dy nivele: Departament, Divizion. Menaxhimi i burimeve njerëzorë bëhet nga vet APR	Rregullimet e parashikuara në LOFASHAP duhet të zbatohen direkt ose duke bërë referencë.
Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare			Mbesin siç janë, nëse ndodhin ndryshime kushtetuese, funksionet e Komisionit të pavarur të Mediave duhet të bëhen bashkë me këtë agjenci.	Përbërja e bordit: të pasqyroj edhe pjesë marrës nga shoqatat profesionale dhe të përdorues të shërbimit				
Zyra e Rregullatorit për Energji			Duhet konsideruar zvogëlimin e funksioneve në energji elektrike dhe shtimin e funksioneve rregullatore ne burimet e tjera te energjisë (gaz, thengjill etj)	Kriteret e emërimit të anëtarëve të bordit duhet të përcaktohen saktë dhe	Kriteret e emërimit të drejtorit duhet të			

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave		Bashkim	Janë të kontestueshme funksionet e rregullimit të tregut duke ditë që shërbimet e hekurudhës ofrohen nga një operator i vetëm dhe i njëjti është shtetëror.	qartë	përcaktohen saktë dhe qartë			
Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës			Janë të kontestueshme funksionet e rregullimit të ekonomisë së aeroporteve duke ditë që në Kosovë ekziston vetëm një aeroport.	Emërimi i anëtarëve: Nga Qeveria me propozim të min. Përgjegjëse, Nga Kuvendi me propozim të Qeverisë ose ex-officio nga vet Kuvendi si zhvillimin e procedurave ashtu edhe emërimin.	Emërimi i drejtorit: Nga Qeveria me propozim të min. Përgjegjëse, Nga Kuvendi me propozim të Qeverisë ose ex-officio nga vet Kuvendi si zhvillimin e procedurave ashtu edhe emërimin.			
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	Mbetet siç është	Mbetet siç është		Menaxhimi financiar dhe i burimeve njerëzore: Nga kryetari i bordit ose Sekretari i Përgjithshëm	Menaxhimi financiar dhe i burimeve njerëzore: Nga Drejtori ose Sekretari i Përgjithshëm			
Komisioni i Pavarur i Medieve	Mbetet siç është	Mbetet siç është vetëm ndrohen vijat e llogaridhënies						

SHËNIM I POLITIKAVE

Shënimi i politikave ofron analiza të shkurta, koncize dhe në kohë, mbi çështje të caktuara. Shënimet e Politikave janë raporte të shkurta të cilat përshkruajnë arsyet mbi përzgjedhjen e një alternative të caktuar të politikave mbi një çështje/debat aktual. Ato zakonisht publikohen për një ngjarje të caktuar dhe avokojnë qëndrime profesionale të Grupit për Studime Juridike dhe Politike. Më saktësisht, Shënimet e Politikave janë dokumente avokuese, të cilat ofrojnë argumente lidhur me përshtatjen/ndryshimet e një politike të caktuar. Shënimet e Politikave kanë për qëllim të ndikojnë një audience të synuar mbi rëndësinë/implikimet/zgjidhjet e një problemi aktual dhe me këtë rast sjellin rekomandime tek politik-bërësit, shoqëria civil dhe media, dhe publiku i gjërë.